



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT  
NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË KUKËS, Z. ZENEL ISMAIL  
GJOKA, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË  
PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Kukës z. Zenel Ismail Gjoka, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, kreu III, pika 3 ç, e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

**VËREN**

Këshilli i Bashkisë Kukës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Këshill për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të Këshilltarit të njërit prej anëtarëve.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave

---

**Nr . 171 i vendimit Data 16.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Kukës, z. Zenel Ismail Gjoka, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar z. Zenel Ismail Gjoka, përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Lëvizja e Legalitetit, ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit më datë 08.04.2019 me numër unik 2130, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Zenel Ismail Gjoka, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa b dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2263 prot., datë 09.04.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2262 prot., datë 09.04.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak, z. Zenel Ismail Gjoka, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1044/1 prot., datë 10.04.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Zenel Ismail Gjoka, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak Kukës. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 10.04.2019 rezulton se z. Zenel Ismail Gjoka:

1. Në bazë të vendimit nr. 70 datë 19.07.1988, Gjykata e Kukësit e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "Përvetësimit të pasurisë socialiste me anë të zhveshjes së makinave", parashikuar nga neni 63 K.P  
Është dënuar me 3 (tre) muaj heqje lirie, në bazë të nenit 64 e 21/a.  
Është dënuar me 5 (pesë) muaj heqje lirie, sipas nenit 101/1 dhe 21/2 K.P.  
Është dënuar me 3 (tre) muaj heqje lirie, sipas nenit 196 dhe 36 të K.P.  
Dënohet me 1 (një) vit heqje lirie.  
Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është Rehabilituar.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Nga shqyrtimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kukës dhe përgjigjes të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se z. Zenel Ismail Gjoka nuk ka deklaruar veprën penale në formularin e vetëdeklarimit, për të cilën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës është dënuar me heqje lirie.

Në kreun III, pika 3, ç) të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", parashikohet se:

*"...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik".*

Në lidhje me faktin nëse mosdeklarimi i të dhënave të cilat parashikohen në pyetjet e formularit të vetëdeklarimit, përbëjnë shkak për përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga

---

**Nr . 171 i vendimit Data 16.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për Këshillin e Bashkisë Kukës, z. Zenel Ismail Gjoka, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është shprehur gjerësisht rast pas rasti dhe në vendimet e mëparëshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Referuar Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore, veprat penale të kryera nga kandidati për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kukës, z. Zenel Ismail Gjoka, nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike".

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar. Z. Zenel Ismail Gjoka është jashtë periudhës së ndalimit.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli bashkiak ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar kreut V paragrafi i fundit, pikës 2, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", konstaton se për kandidatin për këshilltarë bashkie, të dhënat e të cilës nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli bashkiak përkatës dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme për verifikim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, kreu III, pika 3 ç, e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

#### **VENDOSI:**

1. Njoftimin e Këshillit Bashkiak Kukës, për vazhdimin e procedurave, për dhënien e mandatit kandidatit të listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Lëvizja e Legalitetit, z. Zenel Ismail Gjoka, për plotësimin e vendit vakant në këshillin bashkiak.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI -</b>	<b>Anëtare</b>

---

**Nr . 171 i vendimit Data 16.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Kukës, z. Zenel Ismail Gjoka, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"